

**AKT I THEMELIMIT  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“DWS” SH.P.K.**

Sot, në datën 05.09.2024, në qytetin e Tiranës, ortaket e mëposhtem:

**Znj. Pavlina KUMBULLA**, e bija e Pajtim dhe Loreta, lindur ne Chania, Greqi, me 30.11.2000, banuese ne Tirane, ne adrese: Rruga “Pjeter Dangu”, Nd.16, Hyrja 1, Njesia Administrative nr.4, 1007 Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit nr. 033609270 / numri personal K06130061S

1. **Shoqeria “LN Development” Sh.p.k.**, NUIS L71611019L, me seli ne adrese: Rruga “Alajdin FRASHERI”, Qendra I&L”, kati 1, e perfaqesuar nga Administratori Z. Llazimir XHAXHO, i biri i Ilo dhe Lindites, lindur ne Korce, me 07.03.1992, banues ne Tirane, Rruga “Pjeter Bogdani”, P.7, Ap.21, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr. 036787724 / numri personal J20307076O

vendosin të themelojnë Shoqërinë “DWS” SH.P.K., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i te ciles, në përputhje me ligjin nr. 991, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, personi i sipercituar, do të rregullohet permes klauzolave vijuese:

**Neni 1 – Emërtimi dhe Forma e Shoqërisë**

Shoqëria emërtohet “DWS” SH.p.k. dhe themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (në vijim “Shoqëria”).

Shoqëria themelohet në bazë të legjislacionit shqiptar dhe do të ushtrrojë aktivitetin në përputhje me legjislacionin Shqiptar, Aktin e Themelimit dhe dispozitat e Statutit.

**Neni 2 – Selia**

2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: **Rr. “Pjeter Dangu”, Pasuria nr.5/828-N1, zona kadastrale nr. 8120, Njesia Administrative Qesarake, Tirane.**

2.2 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci si në adresa të tjera në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

2.3 Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi.

**Neni 3-Objekti**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

1.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Studimin, projektimin, konsulencen, investimin, financimin, ndertimin, rikonstruksionin, shfrytëzimin dhe/ose administrimin, dhe/ ose mirembajtjen, te ndertesave publike dhe/ose private ne fusha te ndryshme, sipermarrjen zbatuese/sherbyese per realizimin sipas rastit me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave te ndryshme ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj, si: ndertimin e ndertesave publike, private, civile ose industriale, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve,



autostrada, hekurudha, vepra te tjera madhore, hidrocentrale, ujesjellesa, linja mbitokesore dhe nentokesore per energjine dhe telekomunikacionet, ndertimin e veprave ujitesore, centraleve, objekteve turistike, objekteve ushtarake, objekteve te kultit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet, objektet industriale, projektet per perdorim te energjise nga burimet e rinovueshme te gjitha restaurimet ne pergjithesi, rikonstruksione te veprave te artit, montimet e konstruksioneve metalike; si dhe çdo ndertim tjeter; Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese; Prodhimin ne rruge industriale dhe montimin ne veper te strukturave parafabrikate prej betoni te armuar, normal dhe te paranderur, strukturave prej celiku; Montimin dhe mirembajtjen, ose ristrukturimin e sistemeve te ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit te klimes, te impianteve pneumatike si dhe te linjave telefonike te jashme dhe impiante te telekomunikacionit me frekuence te larte, te cfaredo rendesie; Cmontimin i impianteve industriale dhe prishja e plote e ndertesave me paisje special; Montimin, mirembajtjen ose strukturimin e impianteve hidrosanitare te kuzhines, lavanterise te gazit dhe kundra zjarrit, sado qe te jete shkalla e rendesise se veprave; Impiante ngritese dhe transportues (ashensore, shkalle levizese, transportues); Impiante te sinjalistikes ndriçuese te trafikut, injalistikes rrugore jo ndriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare, barriera dhe mbrojtje rrugore; Impiante te brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

- Konsulence teknike ne fusha te ndryshme, projektim, supervizion, menaxhimet dhe studimet e te gjitha llojeve, realizimi i kontratave, marreveshjeve, ekspertizes, planbizneseve, projekte zhvillimi dhe studime te efektiviteteve ekonomike, Administrim fondesh dhe/ose investimesh;
- Tregtimin dhe import-eksportin me shumice e pakice, te te gjitha mallrave te gatshme dhe gjysem te gatshme me ose pa akcize, tregtimin me pakice te naftes, gazit natyror dhe nenprodukteve te tyre; tregtimin me pakice dhe ose me shumice te karburanteve,
- Operimin e Qendrave Tregtare, si dhe aktiviteteve Qiradhenie, Bar-Restorant, Parkim, Qender Fitnessi » (Palester); kend lojrash, qender argetimi per femije te te gjitha moshave, qender per zhvillim te lojrave sportive dhe jo sportive, zhvillim trajnimesh, kurse edukative, sherbime pastrimi (perfshire edhe lavazh automjete), sherbime te shitjes me pakice, sherbime administrim biznesi, reklame, funksione zyre, sherbime informacion biznesi, asistencë menaxhimi, kerkime tregu, promovim shitjesh, organizim ekspozitash per qellime tregtare ose reklame, sherbime agjencie publicitare, rekrutim personeli, dhenie me qira te hapësirave reklamuese, e sherbime te tjera te ushtruara ne Qendra Tregtare ose ne funksion te Qendres Tregtare por edhe si aktivitet te vecanta te kryera jashte Qendres Tregtare per aktivitet e tjera tregtare te saj.
- Implementimi i projekteve te hoteleve, fshatrave turistike, resorteve qendra turistike e te tjera dhe krijimin e faciliteteve dhe aksesoreve te nevojshem ne funksion te tyre.
- Aktivitet ne fushen e mjedisit per mbrojtjen dhe/ose permiresimin si dhe rehabilitimin e kushteve te mjedisit rrethues;
- Prodhim materialesh te ndertimit dhe aksesoreve ne ndertim.
- Sherbime nefushen e pasurive te luajteshme dhe te paluajteshme duke perfshire pa u kufizuar qiradhenie, administrim, menaxhim, mirembajtje, riparim, ndermjetesim etj
- Sherbime te marketingut, promovimit dhe reklamimit. Sherbime te te ndryshme ne fushen e turzimin dhe agrobiznesit. Transport te udhetareve e te mallrave.

#### Neni 4–Kohëzgjatja e Shoqërisë

- 4.1 Shoqëria themelohet dhe ushtron veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 4.2 Shoqëria mund të priset në çdo moment me vendim të Asamblese se Ortakeve, sipas dispozitave ligjore.



## Neni 5 - Kapitali Themeltar dhe Ortakët

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njqindmije) **LEKË**, dhe perbehet nga 2 kuota te derdhura teresisht, te mbajtura nga ortakët e shoqërisë si ne vijim:

1. Ortaku themelues **Pavlina Kumbulla**: Zoteruese e 1 (një) kuote me vlerë **50,000 (pesdhjetemije) Lekë** që përben **50%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Ortaku themelues **“LN Development” shpk**: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë **50,000 (pesdhjetemije) Lekë** që përben **50%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

## Neni 6 – Administrimi

Shoqëria do te administrohet nga administratori i vetem te cilit i jane dhene te gjitha kompetencat e drejtimit te zakonshem.

Administratori i vetem qendron ne detyre per nje mandat 5 – vjecar, me te drejte rizgjedhje, dhe per sa kohe nuk eshte revokuar nga asambleja e ortakeve, si organi me i larte vendimmarres ne shoqëri.

Me kete akt, administrator i pare i shoqërisë emerohet **Znj. Pavlina KUMBULLA**, e bija e Pajtim dhe Loreta, lindur ne Chania, Greqi, me 30.11.2000, banuese ne Tirane, ne adrese: Rruga “Pjeter Dingu”, Nd.16, Hyrja 1, Njesia Administrative nr.4, 1007 Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e leternjofimit nr. 033609270 / numri personal K06130061S

me nje mandat 5 vjecar nga data e emerimit.

## Neni 7 – Vitet Ushtrimore

Vitet ushtrimore mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti. Viti i pare ushtrimor mbyllet me 31 dhjetor 2025.

Vendbanimi fiskal i ortakeve do te jete selia e shoqërisë per cdo efekt ligjor.


Ky akt themelimi eshte hartuar ne Tirane ne pese ekzemplare me vlere te njejte ligjore.

Shoqëria krijohet dhe do te ushtroje aktivitet ne perputhje me ligjet shqiptare ne fuqi, ligjit n. 9901 date 14.04.2008 dhe ligje te tjera qe do te jene ne fuqi gjate periudhes se aktivitetit te shoqërisë, si dhe ne perputhje me statutin qe konsiderohet pjese perberese e ketij akti.

Lexuar, gjetur konform vullnetit te lire e te pavesuar, pranuar dhe nenshkruar nga ortakët e shoqërisë:

## ORTAKET THEMELUES

PAVLINA KUMBULLA

*Pavlina Kumbulla*  


“LN Development” Sh.p.k.  
ADM. LLAZIMIR XHAXHO

